REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 339/19
Datë/Datum. 24.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kunder : **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**
Për Aktivitetin e Prokurimit: **210-19-1666-5-1-1 & nr. Brenshem: 210 19 008 511**

Sa i përket tenderit për: **Rregullimi-pastrimi i lumit Hogosht deri te ura e Domarocit-Ranillug**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"NIKA Pro-ing" & "Bejt Commerc" sh.a.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Rexhep Bislimi, Ferizaj
(Adresa)

Ferizaj
(Vendi)

71000
(Kodi postar)

044 12 11 52
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Ardan Guri
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nika.proing@gmail.com
(Adresa elektronike)

24.06.2019
(Data e parashtrimit të kërkesës)

NIKA PRO-ING SH.P.K. NPI- FERIZAJ

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftim për kontratës me dt: 01.04.2019
Hapja e ofertave me dt:10.05.2019
Njoftim për dhënje kontratës me dt: 06.06.2019
Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letra standarde për tenderues të pa sukseshëm me dt. 06.06.2019
Kerkesa për ri-shqyrtim AK- 10.06.2019
Pergjigja e kerkese për ri-shqyrtim 14.06.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

E kemi pranuar në mënyrë elektronike procesverbalin e hapjes

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

Me daten 06.06.2019, ne platformën elektronike e-prokurimi kemi pranuar Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe Leter standarde per tenderuesin e pasuksesshëm.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne jemi njoftuar me letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm,

Jemi njoftuar me leter standarde per tenderuesin e pa sukseshem ne projektin e lartë permendur ku jemi njoftuar per pikat te cilat nuk e kemi plotesuar kerkese sipas FTD-se:

Ne pretendimin 1. E kundershtojm per aresyje qe ne FTD ceket shum qarte se OE te siguroj Ak-në per materjalet e perdorura të jenë sipas kerkesës, mirpo nuk është kërkes e AK-së që të sjell në këtë fazë qertifkaten EN-13748-2 & ISO 9001:2015, e citojme kerkesen e AK-se : **Operatori ekonomik te siguroj Autoritetin Kontratkues se materialet e pozicionit ku perdoren pllakat terraco me EC (Declaration of Conformity). Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2, ashtu qe duhet te posedojne ateste te çertifikuara me shenjen CE nga proshuesi i cili duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001 2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per sistem hermetik te makinerise prodhuese, per artikullin e kerkuara sipas pozicionit Pllaka terastone njeshtresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (Graniti, Diabaz, Bazalt).**
Ne kete kerkes e kemi plotesuar me Deklarat ku kemi cekun se ne do te ofrojme produktet sipas kerkeses se AK-së,

Ne pretendimin 2. E kundershtojme per aresyje ku cekete se na mungojne dy kamjoneta-min 2 copa & Pompa e ujit 2-copa,
Ne listen e makinerise te Bejta Commerc jane te deshmuar edhe nga ana e Noterit me proceduren EN Minutes se keto makineri edhe tjerat e me shum jan te deshmuar qe jane ne pronesi te OE Bejta Commerc nga Gjilani, duhet te cekim se ne listen e makinerise shkruan Cistern (eshte e njejta) jane deshmit libreza dhe fotografit qe e deshmojn se OE Bejta Commerc posedon 2 cisterna/pumpa te ujit, njashtu ne listen e mekanizimit eshte bere nje gabim teknik te shenimet e kamjoneve jane edhe 2 kamjoneta te cilat jane me libreza dhe te deshmuar me proceduren EN-minutes.

Ne pretendimin 3. E kundershtojme per aresyje se ne listen e stafit te OE Nika Proing eshte ne liste ingjinjeri z. Bashkim Hasani, i cili e ploteson kerkesen e AK-se ku te njejtin e kemi puntor te rregullt ne kompani. // Kete pretendim AK-ja gjatë kërkes për ri-shqyrtim e ka pranuar se kane gabuar.

Ne piken shtesë që AK-ja në kundershtim me LPP-në ka vepruar ka konstatuar se na mungojne Licencat nga Ministria e Bujqesis per prodhim, tregtim dhe import te bimeve dekorative, pasi qe mareveshja e bashkepunimit me z. Naim Maliqi nuk vlen. Ne kemi bere mareveshje te noterizuar me z. Naim Maliqi per plotesimin e kerkese se AK-se edhe nuk ceket ne kerkesn FTD-se qe OE lider duhet ti kete keto licenca, pasi qe natyra e punes eshte ndertimore e jo bujqesore. Edhe duhet te cekemi se AK-ja kete kritert e ka vendosur ne kundershtim me LPP-ne pasi qe ne paramasen e ketij projekti nuk eshte per te mbjellun asnje bime, apo drunje dekorativ. Ne e kemi plotesuar kete kriter pasi qe ne mareveshjen tone te noterizuar e kemi cekun se furnizimet i bene kompania e licencume.

Duhet te cekun se OE i rekomanduar per kontrate nuk eshte i pergjegjeshem pasi nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme 750,000.00€ ku ne raste koncersium lideri duhet te kete 60% te vleres se kerkuar.

- Ne pergjigjen e AK-se se ky pretendim nuk qendron pasi qe tek ky kriter nuk eshte kerkuar qe ne rast koncersiumi lideri duhet te kete 60% te vleres se kerkuar

Ne e ofrojme kerkesen ne FTD te AK-së:

- Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2, Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Operatori ekonomik duhet t'i ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i Operatorit Ekonomik , gjatë tre viteve të fundit deri në njoftimin për kontratë ka qenë gjithsej min. 900,000.00 Euro. **Në rast të konzorciumit, lideri duhet t'i plotësoj 60% të vlerës së kërkuar.**
- *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
- Vertetim nga ndonje banke e licensuar e Kosoves qe deshmon se qarkullimi i OE gjate tri viteve te fundit deri ne njoftimin per kontrate ka qene minimumi 900,000.00 euro

Përfundimisht ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas nenit 60 të LPP-së.

Pas anlizës dhe vërejtjes së lëshimit teknik rezulton se edhe neni 1 dhe neni 6 nuk janë respektuar, sepse dihet që qëllimi i LPP-së është të sigurohet mënyra më efikase, më transparente dhe më e drejtë e shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Kërkojmë nga OSHP-ja, landa e ketij projekti te kthehet në ri-vlersim kërkojmë të na shpallni neve fitues të këtij tenderi, sepse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale i kemi në vlerë prej 80,000.00 € për përgatitje të tenderit dhe shpenzime procedurale.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.